



Financuar nga
Bashkimi Evropian


center for
transparency
and freedom of
information

ema
EUROPEAN MOVEMENT ALBANIA

Raport

2025

RAPORT MONITORIMI, KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË (KLP), 2024



PUBLIKUES

QENDRA PËR TRANSPARENÇË DHE INFORMIM
TË LIRË (CTFI)

Adresa: Rr. Komuna e Parisit, Pal.2, Sh. 2,
Tirana, Albania

Tel: +355 682088602

E-mail: info@transparence.al

Web: www.transparence.al

VITI I PUBLIKIMIT:

2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE” , me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Hyrje	03
Organigrama	04
Buxheti	06
Prokurimet	08
Kosto për vendim këshilli	08
Auditim i KLSH	10
Transparenca	11
Gjetjet dhe përfundimet	12
Rekomandimet	13
Bibliografia	15

Hyrje

KLP-ja u themelua më 19 dhjetor 2018 ndërsa ka të drejtë dhe detyrim ligjor të garantojë pavarësinë, përgjegjshmërinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Shqipëri [1]. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë[2], 6 prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve jo prokurorë. Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët jo prokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Dy anëtarë jo prokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo prokurorë. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme.

KLP-ja ushtron kompetencat kryesore si më poshtë: i propozon Kuvendit kandidatët për funksionin e Prokurorit të Përgjithshëm, emëron prokurorët në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve, emëron, ngre në detyrë dhe vlerëson prokurorët e të gjithë niveleve, etj. KLP-ja, në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik për sistemin e prokurorisë në përputhje me ligjin dhe në bashkërendim me Strategjinë Ndër-Sektoriale të Drejtësisë. Përpara krijimit të KLP funksiononte Këshilli i Prokurorisë i cili nuk kishte kompetenca në vendim-marrje. KLP ndër të tjera propozon dhe administron buxhetin e tij; informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë; ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj [3]. Pra, në kompetencat e saj ajo menaxhon buxhetin e vet.

Pas zbatimit të hartës së re gjyqësore edhe KLP, në janar të vitit 2023, ka kryer ristrukturimin e prokurorive të Apelit, duke shkrië Prokuroritë e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë dhe duke i grupuar ato në një të vetme atë të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë. Ndërsa ristrukturimi i prokurorive në nivelin e shkallëve të para, është konfirmuar nga KLP me datë 24.04.2023 dhe ka hyrë në fuqi me datë 01.05.2023. Kjo ka sjellë shkrirjen e prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë. duke i grupuar ato në 13 prokurori dhe përkatësisht në prokuroritë Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë, Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë.

[1] Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar

[2] Kushtetuta e Shqipërisë, neni 149

[3] Kushtetuta e Shqipërisë, neni 149/a

Organigrama

Sistemi i prokurorisë është i organizuar në 13 zyra prokurorie pranë Gjykatave të Shkallëve të Para; 1 zyrë prokurorie pranë Gjykatës së Apelit; Prokuroria e Posaçme SPAK; Prokuroria e Përgjithshme. Organika totale e miratuar për gjithë sistemin e prokurorisë është 341 prokurorë nga të cilët: 278 në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë; 26 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; 20 në Prokurorinë e Posaçme, SPAK; 17 në Prokurorinë e Përgjithshme. Numri faktik i prokurorëve që ushtronin detyrën në dhjetor 2024 ishte 220 prokurorë [4], nga të cilët: 179 prokurorë në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nga 278 që janë sipas dekretit; 10 prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nga 26 që duhet të ishin; 20 në Prokurorinë e Posaçme, SPAK nga 20 të tillë; 11 në Prokurorinë e Përgjithshme nga 18 që duhej të ishin në detyrë.

Nga ana tjetër në fund të vitit 2023, kishte gjithsej 129 vakanca, nga të cilat 55 prej tyre ishin vakanca të përhershme ndërsa 74 ishin vakanca të përkohshme të shkaktuara kryesisht nga vendimet e shkarkimit nga detyra të prokurorëve nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Struktura organizative e KLP-së ishte e përbërë nga 72 punonjës për vitin 2024. Ndërsa në faqen në internet të KLP thuhet se janë 75 punonjës, me 3 janar 2024 numëronin 7 vakanca ose 10%. Përgjatë vitit 2024 kanë punuar 64 punonjës [5].

KLP ka 4 komisione mes të cilëve është edhe Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Një nga detyrat e këtij komisioni është edhe hartimin e projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm të Këshillit, në konsultim me Ministrinë e Financave. Komisioni i Buxhetit ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me nenin 40, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” ndërsa tek detyrat e tij përfshihen edhe: mirëorganizimi i fondeve buxhetore dhe miratimi i kërkesave buxhetore. Në strukturën e KLP nuk është parashikuar si njësi më vete, struktura e auditit të brendshëm i institucionit çfarë është gjetur si shkelje nga ana e KLSH.

Anëtarët e KLP paguhën sipas grupit G3 të pagave në sistemin e drejtësisë. Po aq paguhet edhe këshilltari i etikës në KLP. Prokurorët paguhën edhe për orët e punës jashtë orarit, në ditët e festave apo në fundjavë. Sipas “Rregullores për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”, miratuar që në fillim të aktivitetit të KLP, tek neni 7 ‘Mënyrat e kompensimit’, përcaktohet se prokurori që ushtron funksionin jashtë orarit zyrtar, në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare përfiton kompensim financiar me shtesë page mbi pagën normale të tij ose kompensim me kohë pushimi [6].

[4] Raporti vjetor i KLP, 2024 f.52

[5] Raporti vjetor i KLP, 2024 f.54

[6] Rregullore e KLP “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”, 13.05.2019

“Prokurori qe ushtron funksionin ne ditët e pushimit javor apo festave zyrtare si dhe orët shtese te kryera ne orarin 22.00 – 06.00, përfiton shtese page ne masën 50 % te pagës se tij ditore ose kompensim me kohe pushimi. Prokurori qe ushtron funksionin jashtë kohës normale te punës përfiton shtese page ne masën 25% te pagës se tij ditore ose kompensim me kohe pushimi. Drejtuesi i Prokurorisë do te kompensoje financiarisht prokuroret sipas percaktimeve te ketij neni. Ne rastin e pamundesise se kompensimit financiar atëherë prokurori do te kompensohet me kohe pushimi ne rastet kur e sheh te mundur, me nje pushim te paktën 25% me te madh (ne rastin e oreve jashtë orarit zyrtar) qe i korrespondon kohëzgjatjes se orëve shtese dhe 50% me te madh (ne rastin e punës ne ditët e festave zyrtare apo pushimit javor, te shtune ose te diele) qe jepet brenda 1 muaji nga dita e kryerjes se punës.

Ndërsa në nenin 9 të kësaj rregulloreje [7] thuhet se prokuroria duhet te ketë fonde te miratuara për ketë qëllim në buxhetin vjetor te saj. Kufizimi që fondi i përcaktuar për orët jashtë orarit nuk duhet të tejkalojë më shumë se 200 orë në vit për cdo prokuror është hequr nga kjo rregullore përmes një amendimi që iu bë asaj në vitin 2024 [8]. Në vendimin e ri të KLP thuhet se paragrafi në nenin 9 të rregullores së vitit 2019 shfuqizohet. Pra, përcaktimi se “Fondi i përcaktuar për orët jashtë orarit nuk duhet të tejkalojë më shumë se 200 orë në vit për cdo prokuror”, nuk është më në fuqi. KLP-ja, gjatë vitit 2023, ka marrë gjithsej 200 vendime.

Prokurorët përfitojnë ndërkaq edhe kredi të financuar nga shteti për strehim sipas kriterëve të përcaktuara me VKM [9] dhe ligjit 97/2016 [10]. KLP ka bërë dy thirrje përgjatë vitit 2024 ndërkohë që vendimet për dhënie kredie janë publikuar në faqen e KLP [11]. KLP ka ndërmarrë edhe hapa në lidhje me adresimin e stokut në çështje penale që lidhet edhe me punën e prokurorëve. Rezoluta e Kuvendit për KLP për vitin 2023 i ka kërkuar këtij institucioni të përfshihet na masat për uljen e stokut edhe në sistemin e prokurorive. Në pikën 6 të rezolutës [12] theksohet: Të hartohet një metodologji dhe të ndërmerren hapa konkretë për të zvogëluar stokun e prapambetur në të gjitha nivelet. Me ndihmën e projektit EU4JUSTICE [13], disa ekspertë po bëjnë një studim për të përcaktuar ngarkesën vjetore të prokurorëve, në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të Lezhës dhe Elbasanit dhe njëkohësisht duke e krahasuar atë me mesataren e CEPEJ. Studimi ndërkaq është edhe një masë në lidhje me rekomandimin e rezolutës së Kuvendit për raportin e KLP, 2023, rekomandimi Nr. 6, ku kërkohet që të hartohet një metodologji dhe të ndërmerren hapa konkretë për të zvogëluar stokun e prapambetur në të gjitha nivelet.

[7] Po aty

[8] Vendimi Nr.49, datë 12.04.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr.91, datë 13.05.2019, "Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit"

[9] VKM Nr.22, datë 15.01.2020, "Për miratimin e procedurës së detajuar, të kriterëve dhe të kushteve që magjistrati duhet të përmbushë

për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e së cilës financohen nga shteti"

[10] Neni 17, ligji Nr.97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar

[11] <https://klp.al/2024/12/03/vendime-te-marra-nga-klp-ja-ne-daten-27-11-2024/>

[12] Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023

[13] Raporti vjetor i KLP, 2024 f.76

Buxheti

Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin 2024 administroi dhe menaxhoi fondet nga Buxheti i shtetit të miratuara [14] në Kuvend në vlerën 214,083,000 lekë.
Plani fillestar i buxhetit ishte 214,083,000 lekë ose 2.1 milionë euro. Plani me ndryshime ishte 216,994,000 lekë ndërsa realizimi ishte 199.960, 000 lekë ose 92%.

Përbëja e shpenzimeve buxhetore, është si më poshtë:

Llog	Emërtimi	Plani fillestar i buxhetit viti 2024	Plani i buxhetit viti 2024	Realizimi faktik 12-mujor 2024	Realizimi faktik 12-mujor 2024
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	152,840	151,000	145,596	96%
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	20,760	18,600	17,027	92%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	30,483	34, 083	34,078	100%
606	Transferte te individët	4000	3,311	3,259	98%
	Totali	214083	216994	199960	92%

[4] Vendim i KLGJ, nr. 743, datë 28.12.2023 për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor
[5] Filloreta Ajdini, përgjegjëse e buxhetit në GJL, takim me 22 korrik 2025
[6] Po aty.

Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelën më sipër buxheti për periudhën janar-dhjetor 2024 është realizuar në masën 92%.

Investimet publike (231) nuk janë realizuar fare duke mos shpenzuar asnjë lek nga fondi i planifikuar prej 10.000.000 lekë [15].

Këshilli nuk ka qenë i kënaqur më masën e buxhetit miratuar fillimisht nga ministria e Financave për vitin 2024. Këshilli ka miratuar kërkesat buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 por nga ministria e Financës nuk janë marrë në konsideratë kërkesat për ndryshime, pasi në miratimin e tavanëve me Vendimin Nr.436, datë 19.07.2023 për “Miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, e Këshillit të Ministrave, reflektohen tavanë më të vogla nga ato të propozuara.

Ky problem është shtruar më 07.11.2023, përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend.

Kërkesat për shpenzimet buxhetore të PBA për vitet 2024-2026 janë pranuar pjesërisht nga ky Komision i cili ka miratuar numrin prej 72 punonjës.

Për vitin 2024, fondi i pagave (600) është 155,000,000 lekë, i cili në fakt ka qenë më i ulët sic shihet në tabelën e mësipërme (151,000,000) dhe fondi për kontributet e sigurimeve shoqërore (601) është 18,600,000 lekë.

Ndërkaq Kuvendi përmes rezolutës për KLP në lidhje me raportin për vitin 2023 “Rezolutë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për Raportin Vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vitin 2023”, ka kërkuar të merren masa për digjitalizimin e arkivave të sistemit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm për ruajtjen, sistemimin dhe digjitalizimin e arkivave të sistemit të prokurorisë në tërësi KLP, gjatë vitit 2024, ka bërë një studim mbi digjitalizimin e sistemit të brendshëm, ku përcaktohet procesi i komunikimit digjital mes strukturave dhe anëtarëve të Këshillit. Me hartimin e PBA, gjatë vitit 2025, KLP do t'i kërkojë Kuvendit një fond të dedikuar për ta zbatuar këtë studim në praktikë, me qëllim përmirësimin e performancës së veprimtarisë së Këshillit (rekomandimi 10).

Në matricën e menaxhimit të riskut të Plani Strategjik 2021-2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, mungesa e burimeve financiare konsiderohet me risk të ulët dhe si masë parandaluese sugjerohen dy të tilla: raportim shterues në Kuvend dhe i bazuar në të dhëna; mundësi e lëvizjes së burimeve të pashpenzuara në buxhet.

Por në strategjinë e riskut të miratuar më 12 dhjetor 2023 theksohet se një risk i jashtëm është vendosja e tavanëve buxhetore nga Ministria e Financave, ngrirja e fondeve të akorduara me ligj vjetor nga ministria e Financave dhe shkurtimi i fondeve nga aktet normative të propozuara nga ministri e Financave [16]. Ky risk konsiderohet me probabilitet të lartë dhe impakt të lartë ndërsa si zgjedhje janë parashikuar argumentet për nevojat ndërsa si trupë e aktivizuar ndaj këtij risku janë zyrtarët e financës dhe buxhetit në KLP si dhe Sekretari i Përgjithshëm.

[15] Raporti vjetor i KLP, 2024 f.58

[16] Strategjia e menaxhimit të riskut, 2023, f.8

Risk i jashtëm, mosakordimi i fondit të veçantë nga MF në Institucion dhe bllokimi i te drejtës së Sekretarit të Përgjithshëm të motivojë punonjësit për punën. Si aksion për neutralizimin e këtij risku që vlerësohet më probabilitet të mesëm dhe impakt të mesëm është ‘fondi i veçantë’ që duhet të negociohet me MF që të akordohet në përputhje me bazën ligjore, dhe dhënia e te drejtës së Sekretarit të Përgjithshëm të motivojë punonjësit [17].

Një risk tjetër lidhet me planifikimin e buxhetit i vlerësuar si risk i brendshëm me probabilitet të mesëm dhe impakt të lartë është ai që lidhet me thellësinë e analizës që shërbimet në Institucion bëjnë për vlerësimin e nevojave buxhetore në kuadër të PBA.

Dy risqe të tjera të brendshme lidhen me menaxhimin e aktiveve në institucion: a) mosnjohja dhe mosrespektimi i burimeve të auditimit në menaxhimin e aktiveve dhe atë të prokurimeve dhe b) mosplanifikimi i një mirëmbajtjeje për aktivet për t’i orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese me mirë se drejt riparimit të avarive [18].

Në raportin vjetor të KLP janë nënvizuar prioritetet e punës së këtij institucioni përgjatë vitit 2025, ku ndër tjera i kushtohet vëmendje edhe menaxhimit të buxhetit.

“Optimizimi i menaxhimit buxhetor, duke synuar një përdorim më efikas të fondeve dhe një planifikim më të mirë për periudhën afatmesme, në përputhje me prioritetet e institucionit”, është një nga prioritetet e KLP për vitin 2025.

Prokurimet

Në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve janë parashikuar 19 prokurime për vitin 2024. Blerjet me një buxhet më të lartë janë ato për pajisje TIK dhe software në vlerën e afro 4.1 milionë lekëve. Ndërkaq janë realizuar 13 procedura prokurimi ku mungojnë blerjet për TIK dhe software.

Kosto për vendim këshilli

Gjatë vitit 2024 janë marrë 301 vendime nga 200 të parashikuara, me një kosto 199,960,000 lekë. Kosto faktike për njësi (pra, vendim të marrë) është 664,319 lekë.

[17] Strategjia e menaxhimit të riskut, 2023, f.9


[18] Po aty, f.11

Gjatë vitit 2023 janë marrë 406 vendime nga 300 të parashikuara me një kosto për një vendim 460,579 lekë [19].

Për vitin 2022 kosto për njësi ka qenë 712,727 lekë, janë marrë 200 vendime. Ndërsa kosto në vitin 2021 ka qenë 710,750 lekë ndërsa janë marrë 200 vendime. Për KLP është llogaritur kosto për produktin “vendime të marra nga këshilli”:

Tab: Kosto për vendime të marra nga KLP në vitet 2021-2024

Viti/nr.vendimeve	Kosto për vendim/lekë
2021/200	710,750
2022/200	712,727
2023/406	460,579
2024/200	664,319



[19] Shënim: Tek aneksi 3.2 deviacioni i koston për njësi në raportin e monitorimit për vitin 2023 ka një shifër tjetër të koston për njësi për produktin 'vendime të KLP'. Kosto është 625,285 lekë për shpenzime në masën 187,585,500 lekë

Auditimi i KLSH

KLSH ka kryer auditimi financiar në KLP për periudhën nga 2021 deri në 2023 nëse për këtë periudhë trevjecare transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të KLP-së, referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar; nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e KLP, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Në përfundim të auditimit përmes një raporti të auditimit publikuar në maj 2024 janë përcaktuar edhe gjetjet e rekomandimet e kontrollit të KLSH.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi janë si në vijim:

- Përbërja e komisionit për inventarizimin e aktiveve për 2 vite radhazi ka qenë e njëjtë për 4 nga 5 anëtarët, kjo në kundërshtim me pikën 84, të UMF nr.30/2011, ku përcaktohet se: “Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision”.
- Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit rezultoi tejkalim i afateve për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga thesari rezultojnë se për vitin 2022 dhe vitin 2023 janë 20 raste ose 4 % e totalit të transaksioneve të likuiduara jashtë afatit 30 ditorë dhe 50 raste ose 10% e total transaksioneve të likuiduara jo në respektim të rregullit hyrje e pare dalje e pare. - gjatë vitit 2022 janë kryer afërsisht 230 transaksione nga këto konstatohet se 17 raste ose 7 % e total transaksioneve janë likuiduar përtej afatit 30 ditor nga data e faturës së operatorit ekonomik.
- Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se: Në strukturën organike të KLP-së miratuar me Vendimin Nr. 36, datë 06.03.2019 të KLP dhe Vendimin Nr.73, datë 24.04.2023 të ndryshuar, nuk është përfshirë struktura e Auditit të Brendshëm, si njësi më vete.

KLSH ka bërë rekomandimet përkatëse në lidhje me gjetjet e mësipërme:

- Rekomandimi 1.1 Nëpunësi Autorizues të marrë masa për ngritjen e një komisioni për saktësimin e gjendjes së inventarit dhe në rastet e mungesave të evidentohen personat përgjegjës dhe të bëhen veprimet kontabël rregulluese të bazuara në urdhrin e Nëpunësit Autorizues.
- Rekomandimi 1.2 Nga Nëpunësi Zbatues, duhet që në regjistrimin e gjendjes reale të aktiveve, në kundër parti, të mungesave të aktiveve, të njihen të drejtat ndaj personave përgjegjës për mungesat, bazuar kjo në Urdhrin e Nëpunësit Autorizues.
- Rekomandimi 2 Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të merren masa për sigurimin e likuiditetit të mjaftueshëm me qëllim financimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore dhe ekzekutimit të tyre në procesimin normal të ciklit të menaxhimit të shpenzimeve buxhetore duke respektuar afatet, radhën dhe prioritet e pagesave buxhetore.

Rekomandimi 3 Të merren masa nga KLP për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm dhe nëse, nuk plotësohen kushtet e parashikuara në VKM Nr.83 Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, në pikën 6 germa a) bazuar dhe në Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimit e brendshëm në sektorin publik i ndryshuar neni 3, germa “a”, si dhe neni 10, pika 1, germa “b” të bashkëpunohet me njësi Auditit të Brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse [20].

Transparenca

Në programin e Transparencës janë pasqyruar 56 kërkesa dhe përgjigje për KLP gjatë vitit 2024. Kërkesat kanë marrë përgjigje sipas afateve të parashikuara nga ligji ndërkohë që nuk janë publikuar përgjigjet.

KLP ka publikuar në faqen e vet tek ‘Dritarja e transparencës’ regjistrin e realizimeve të prokurimeve dhe atë realizimeve [21], por në formate të çrregullta [22].

Po ashtu është publikuar raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2024 dhe raportet 4 mujore me skanime të dobëta dhe pa mundësi të konsultimit ‘user friendly’ të shifrave.

Raporti vjetor i KLP nuk ishte publikuar deri më 17 qershor 2024 kur është bërë edhe monitorimi i fundit i faqes së KLP.al për efekt të këtij raporti.

Në n/faqen ‘Programi i Transparencës’ nuk janë hedhur edhe regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve në KLP. Ato janë publikuar tek një zone tjetër të faqes.

Tek këndi e drejta për tu informuar dhe për të ankimuar janë dhënë kontaktet e për koordinatorin e të drejtës së Informimit, kërkesa për informim së bashku me modelin e kërkesës, procedura e ankimit.

[20] Raport përfundimtar i auditimit i KLSH “Auditim financiar në Këshillin e lartëtë Prokurorisë”, maj 2024

[21] Udhëzimi i APP nr.4, 18.06.202 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”

[22] Vendim i APP Nr.7, datë 01.08.2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne manualin teknik qe shoqeron udhezimin nr. 04 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”

Gjetjet dhe përfundimet

Për vitin 2024 Këshilli i Lartë i Prokurorisë administroi dhe menaxhoi fondet nga Buxheti i shtetit të miratuara [23] në Kuvend në vlerën 214,083,000 lekë.

Plani fillestar i buxhetit ishte 214,083,000 lekë ose 2.1 milionë euro. Plani me ndryshime ishte 216,994,000 lekë ndërsa realizimi ishte 199.960,000 lekë ose 92%.

Në fondi investimeve nuk është shpenzuar asnjë lek, pra realizimi është 0%.

KLP ka ndryshuar rregulloren për pagesat jashtë orarit duke hequr ndër të tjera edhe kufizimin 200 orë që ishte në rregulloren e mëparshme miratuar në vitin 2019.

KLP ka marrë disa vendime për kredi për prokurorët të financuar nga shteti.

KLP parashikon si risk të jashtëm vendosja e tavaneve buxhetore nga Ministria e Financave, ngrirja e fondeve të akorduara me ligj vjetor nga ministria e Financave dhe shkurtimi i fondeve nga aktet normative të propozuara nga ministri e Financave. Ky risk konsiderohet me probabilitet të lartë dhe impakt të lartë. Risk tjetër është mosakordimi i fondit të veçantë nga MF në Institucion dhe bllokimi i te drejtës së Sekretarit të Përgjithshëm të motivoje punonjësit për punën.

Në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve janë parashikuar 19 prokurime për vitin 2024. Blerjet me një buxhet më të lartë janë ato për pajisje TIK dhe software në vlerën e afro 4.1 milionë lekëve. Ndërkaq janë realizuar 13 procedura prokurimi ku mungojnë blerjet për TIK dhe software.

Gjatë vitit 2024 janë marrë 301 vendime nga 200 të parashikuara, me një kosto 199,960,000 lekë. Kosto faktike për njësi (pra, vendim të marrë) është 664,319 lekë.

Rezoluta e Kuvendit për KLP për vitin 2023 i ka kërkuar këtij institucioni të përfshihet në masat për uljen e stokut edhe në sistemin e prokurorive. Në pikën 6 të rezolutës [24] theksohet: Të hartohet një metodologji dhe të ndërmerren hapa konkretë për të zvogëluar stokun e prapambetur në të gjitha nivelet. Me ndihmën e projektit EU4JUSTICE [25], disa ekspertë po bëjnë një studim për të përcaktuar ngarkesën vjetore të prokurorëve, në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të Lezhës dhe Elbasanit dhe njëkohësisht duke e krahasuar atë me mesataren e CEPEJ.

[23] Ligji 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024"

[24] Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023

[25] Raporti vjetor i KLP, 2024 f.76

Në këtë studim do të vlerësohet gjendja aktuale e çështjeve të prapambetura dhe do të propozohet një mekanizëm për reduktimin e këtij backlog-u.

KLP ka publikuar në faqen e vet tek ‘Programi i transparencës’ regjistrin e realizimeve të prokurimeve dhe atë realizimeve [26], por në formate të çrregullta [27].

Po ashtu është publikuar raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2024 dhe raportet 4 mujore me skanime të dobëta dhe pa mundësi të konsultimit ‘user friendly’ të shifrave.

Raporti vjetor i KLP nuk ishte publikuar deri më 17 qershor 2024 kur është bërë edhe monitorimi i fundit i faqes së KLP.al për efekt të këtij raporti.

Në n/faqen ‘Programi i Transparencës’ nuk janë hedhur edhe regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve në KLP. Ato janë publikuar tek një zone tjetër të faqes.

Rekomandimet

KLP të shpjegojë më tej rreth shpenzimeve në pjesën shpjeguese të raportit vjetor të monitorimit të buxhetit. Kjo pasi ndihmon në kuptimin e këtyre shpenzimeve edhe për persona që kanë njohuri të zbehta rreth formularëve të raportimit.

KLP të trajtojë në raportet e saj vjetore çështjen e stokut në prokurori. Në vitin 2022 kjo çështje është prekur lehtë ndërsa në vitin 2023 kjo çështje nuk është prekur. Në vitin 2024 është vendosur zhvillimi i një studimi në lidhje me stokun në dy prokurori dhe më pas do të ndërtohet një strategji. Është fakt se stoku në çështje penale në gjykata është më i vogël se sa në çështje civile dhe administrative por megjithatë ka stok në çështjet penale. Adresimi i stokut nga prokuroria është i avashtë dhe ndërkaq edhe i paqartë në hapat që ndërmerren në raport me ato që po kryen tashmë gjyqësori dhe i pakoordinuar me këtë të fundit.

[26] Udhëzimi i APP nr.4, 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”

[27] Vendim i APP Nr.7, datë 01.08.2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne manualin teknik qe shoqeron udhezimin nr. 04 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”

Numri i vakancave në sistem është mjaft i lartë dhe një studim i shpërndarjes së punës së prokurorëve do të rriste efikasitetin e tyre në raport me nevojat. Për vitin 2024 numri i vakancave në prokurori ishte 121 prokurorë nga 341 prokurorë sipas dekretit. Aktualisht punojnë 220 prokurorë.

KLP të aplikojë mundësinë e paraqitjes së kërkesave për buxhet në Kuvend kur nuk arrihet plotësimi i kërkesave në raport me tavanet e vendosura nga Ministria e Financave.

Ndryshimet në rregulloren që siguron pagesat për punën jashtë orarit duket të kryhen të harmonizuara edhe me institucione të tjera të drejtësisë dhe në diskutim edhe me ministrinë e Financave, në mënyrë që kjo e fundit të mos bëhet pengesë në kryerjen e proceseve të punës në prokurori.

Bibliografia

Legjislacioni dhe Akte Ligjore

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji Nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”
- Ligji Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji 97/2023 “Per buxhetin e vitit 2024”
- Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- Udhëzimi nr.4, 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”
- Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023
- Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të këshillit të lartë të prokurorisë”
- Vendimi Nr.49, datë 12.04.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.91, datë 13.05.2019, “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit”
- Vendim i APP Nr.7, datë 01.08.2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne manualin teknik qe shoqeron udhezimin nr. 04 datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik"
- VKM Nr.22, datë 15.01.2020, “Për miratimin e procedurës së detajuar, të kritereve dhe të kushteve që magistrati duhet të përmbushë për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e së cilës financohen nga shteti”

Analizë dokumentesh për institucionin e monitoruar

- Euralius-Plani Strategjik 2021-2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë
- Raporti vjetor i KLP, 2024, 2023, 2022
- Raporti i auditit të KLSH i vitit 2024 për vitet 2022-2023
- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit 2024
- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit 2023
- Raport përfundimtar i auditimit i KLSH “Auditim financiar në Këshillin e lartëtë Prokurorisë”, maj 2024
- Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023
- Strategjia e menaxhimit të riskut në KLP, 2023

Burime të tjera

- Eni Lasku, Koordinatorë për të drejtën e informimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Komunikim